



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN 4/MUJORI I PARË I VITIT 2024

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor" është hartuar "Raporti për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën 4/mujori i parë i vitit 2024.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshtë:

- *Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*
- *Ligjin nr.68 /2017"Per financat e vetëqeverisjes vendore"*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008" Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.*
- *Ligji " Për buxhetin e vitit 2024"*
- *Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018."Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.01 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024".*
- *Në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 25 date 22.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024" si dhe të gjitha vendimeve apo urdhërave për ndryshime dhe rishikime të buxhetit gjatë vitit 2024.*

Raporti paraqet punën e administratës të Këshillit të Qarkut Korçë në zbatimin e politikave të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut si në realizimin e burimeve të të ardhurave ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një ritje të cilësisë të shërbimeve të ofruara. Ai përqendrohet kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më të mirë të shpenzimeve për vitin 2024.

### **CILI ËSHTË MISIONI I QARKUT KORÇË**

Misioni i Këshillit të Qarkut Korçë është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore në plotësim të funksioneve të veta ligjore, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Këshilli i Qarkut ofron bashkëpunimin dhe koordinimin midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, si dhe bashkëpunimin e koordinimin e politikave midis njësive të qeverisjes vendore të rajonit.

Këshilli i Qarkut Korçë ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithëpartnerëve lokalë e rajonalë për pjesëmarrje në projekte gjithëpërfshirëse. Këshilli i Qarkut ofron partneritetin e tij për pjesëmarrje në Programet ndërkufitare të financuara nga Bashkimi European etj, me synim zhvillimin ekonomik social të Rajonit dhe ritjen e cilesisë së shërbimeve për komunitetin.

### **OBJEKTIVAT E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2024**

Disa nga objektivat kryesore të Këshillit të Qarkut për vitin 2024

- *Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.*
- *Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korçë.*
- *Pjesëmarrja në Programet ndërkufitare e me gjerë dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.*
- *Nxitjen e bashkëpunimit midis njësisve të qeverisjes vendore të Rajonit, si dhe bashkëpunimin ndërrajonal.*
- *Përmirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.*
- *Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njësisve përbërëse të tij, në procesin e Integritetit European.*

### **REALIZIMI I BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR PERIUDHËN 4/MUJORI I PARË VITIT 2024**

Zbatimi i Buxhetit të Këshillit të Qarkut për 4/mujorin e parë të vitit 2024 ka ecur në kushte normale, kjo si rezultat i një planifikimi të mbështetur mbi burime reale të të ardhurave të vetë Institucionit si dhe një menaxhim të mirë të shpenzimeve në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe programeve të planifikuara për këtë vit.

#### ***Burimet e financimit :***

- Tëardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

#### ***Funksionet kryesore të strukturave financiare :***

- Për funksionet e veta
- Për funksionet e përbashkëta
- Për funksionet e deleguara

#### **➤ Analiza e realizimit të të ardhurave për periudhën 4/mujori i parë i vitit 2024**

Të ardhurat e veta për periudhën 4/mujori i parë i vitit 2024 janë parashikuar sipas metodës dinamike duke marrë në konsideratë të dhënat e ecurisë së arkëtimit të viteve të fundit, dhe realizimit faktik të vitit 2023.

**Llojet e të ardhurave që ka arkëtuar institucioni gjatë periudhes kanë qënë si mëposhtë:**

- Të ardhura nga tarifat e ndryshme që institucioni ka të përcaktuara me akte ligjore dhe me vendime të Këshillit të Qarkut në funksion të shërbimeve që ai i ofron komunitetit.
- Të ardhurat e trashëguara nga viti buxhetor 2023, të cilat janë planifikuar të përdoren për financimin e shpenzimeve të planifikuara për këtë vit buxhetor.

Gjatë kësaj periudhe Institucioni përgjithësisht ka ecur drejt përmbushjes së objektivave dhe parashikimeve të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut duke patur parasysh një balancë të drejtë midis burimeve të financimit dhe realizimit të shpenzimeve në përmbushje të aktiviteteve dhe programeve të miratuara për vitin 2024.

**Të ardhurat në buxhetin e Këshillit të Qarkut për këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:**

ne 000/lekë

Te ardhurat	Plani 2024 4/mujor	Fakti 2024 4/mujor	Realizim ne %	Diferenca ne leke
1. Transferta e pakushtezuar	37084	37084	100	0
2. Te ardhurat e veta	8424	63.8	0.75	8360.2
a. Te ardhura nga tarifat	117	63.8	54	53.2
b. Kontributi financiar i bashkive	8307	0	0	8307
3. Te ardhura te trashëguara 2023	45793	45793	100	0
4. Transferta e kushtezuar	12515.9	12515.9	100	0
a. DAMT	3530	3530	100	0
b. Fondi social	8985.9	8985.9	100	0
<b>Totali 2023</b>	<b>103816.9</b>	<b>95456.7</b>	<b>92</b>	<b>8360.2</b>

*Për vitin 2024 është lënë në buxhet me kapitull 2 nje limit prej 67 milion lekësh per te ardhurat që Këshilli i Qarkut pret të marrë si rimbursim shpenzimesh për shpenzimet e kryera nga fondet e buxhetit per projektet me financim te huaj. Aktualisht projektet e huaja kanë përfunduar, por Këshilli i Qarkut pret të arkëtojë fondet pas certifikimit të shpenzimeve te kryera paraprakisht nga buxheti i institucionit. Deri në muajin Prill 2024 janë situar në buxhetin e Këshillit të Qarkut 9044 mijë lekë si rimbursim shpenzimesh, ose 13.5% e planit. Presim në vazhdim arkëtimin e rimbursimit të shpenzimeve nga donatorët e huaj për të gjitha projektet qe Qarku ka qënë pjesë dhe ka finalizuar.*

Për sa i përket të ardhurave të tjera, sipas tabelës të mësipërme, Për 4/mujorin e parë të vitit 2024, të ardhurat në buxhet janë realizuar në vlerë 95456.7 mijë lekë ose 92% e planit, të ndara sipas natyrës janë:

Transferta e pakushtezuar me vlerë 37084 mijë lekë, për 4/mujorin e parë të vitit 2024, është realizuar 100%, kjo e ardhur vazhdon të jetë burimi kryesor i të ardhurave dhe është përdorur për financimin e funksioneve të veta në mbështetje të legjislacionit në fuqi. Celja e saj është bërë në mbështetje të planit fillestar të buxhetit të ndarë në tremujorë. Gjatë kësaj periudhe nuk është bërë asnjë ndryshim në transfer tën e pakushtezuar.

Të ardhurat e vetë institucionit për 4/mujorin e parë të vitit 2024 janë realizuar ne vlerë 63.8 mijë lekë 0.75 % e planit, me një diferencë në buxhet 8360.2 mijë lekë. Theksojmë se këto të ardhura planifikohen mbi bazën e realizimeve të periudhave të mëparshme. Për nga vetë natyra që kanë, nuk

mund të parashikohen saktë arkëtimet nga tarifat e DAMT-së dhe nga viti në vit këto arkëtime janë në rënie. Realizimi nga tarifat e DAMT-së është 54%.

Për sa i përket të ardhurave nga kontributi financiar i Bashkive të Qarkut, duke qënë se realizimi për këtë zë ka qënë gjithmonë i ulët, është menduar nga grupi i hartimit të buxhetit se një mënyrë për të nxitur Bashkitë për të derdhur kontributet e tyre në Qark, do të ishte propozimi që Qarku do të financojë Bashkitë në raport me kontributin që Bashkia do të derdhë në Qark, për projektet e ndryshme të investimeve që lidhen kryesisht me turizmin dhe që i shërbejnë të gjithë Rajonit. Duke pasur edhe dakordësinë e bashkive për këtë fakt, për vitin 2024 është ritur ndjeshëm plani i realizimit të të ardhurave nga kontributet e bashkive. Konkretisht për 4/mujorin e parë të vitit 2024 ky plan është 8307 mijë lekë, ku 4307 mijë u shtuan me vendimin e Këshillit të Qarkut nr.14 dt.15.03.2024 "Mbi disa ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024", pas propozimit të bashkive në mbledhjet e kryesisë. Aktualisht ky zë mbetet me 0% realizim. Presim realizimin e tij në periudhat në vazhdim.

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2023 në total janë në vlerën 45793 mijë lekë (grant + të ardhura), të cilat janë planifikuar të përdoren sipas vendimeve të Këshillit të Qarkut. Këto fonde janë në nivele të larta sepse një pjesë e mirë e projekteve të investimeve të parashikuara për vitin 2023 nuk aritën të përfundoheshin brenda vitit 2023 dhe financimet e tyre do të mbyllën në vitin 2024, gjithashtu fondet janë akumuluar gjatë 7 viteve të fundit dhe janë planifikuar të përdoren kryesisht në projektet IPA si për financimet e 15 % të pjesëmarrjes në buxhetet e Projekteve të fituara nga Programet IPA CBC 2014-2020 si dhe fonde të mjaftueshme për parafinancimet. Implementimi i këtyre projekteve ka filluar në vitin 2018 dhe financimi i tyre ka qënë sipas parashikimit në kontratat përkatëse. Në fund të vitit 2023 kanë përfunduar të gjitha projektet me financim të huaj dhe janë në proces kontrolli dhe certifikimi përfundimtar. Aktualisht Këshilli i Qarkut Korçë është në proces aplikimi për të qënë pjesë e projekteve të tjera me financim të huaj.

*Të ardhurat e realizuara në total janë përdorur për financimin e funksioneve të veta të përcaktuara si më poshtë:*

- *Pagat e personelit,*
- *Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit.*
- *Për shpenzime operative*
- *Investime*
- *Bashkëfinancim Projekte të BE*
- *Investime në infrastrukturë sipas propozimeve të bashkive dhe miratimit në Këshillin e Qarkut*

#### **Të ardhura nga fondet e kushtëzuara për vitin 2024**

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Qarkut ka përfituar nga buxheti i shtetit fonde nga buxheti i kushtëzuar në shumën prej **12515.9 mijë lekë**, nga të cilat 3530 mijë është transferta e kushtëzuar për 4/mujorin e parë të vitit 2024 për funksionin e deleguar të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes në Qark. 8985.9 mijë lekë është fondi social, transferta e kushtëzuar nga Ministria e Shëndetësisë, për financimin e pagave dhe sigurimeve të punonjësve të qëndrave të moshës të tretë, pas miratimit të projektit të propozuar nga Këshilli i Qarkut. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndryshime në transfertën e kushtëzuar.

### Analiza e realizimit të shpenzimeve për periudhën 4 mujori i parë i vitit 2024

Shpenzimet e buxhetit gjatë kësaj periudhe janë realizuar në shumën prej **10122.5 mije lekë** nga **104437.9 mije lekë** të planifikuara ose **10 %**.

Nga totali i shpenzimeve për periudhën 4 mujore, shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **6661.8 mije lekë** ose **62.4%** ndaj planit prej **10678.5 mije lekë** vetëm për programin 01110 të miratuar për administratën e Këshillit të Qarkut. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve lidhet kryesisht me mosrealizimin e disa prej zerave të shpenzimeve operative të planifikuara gjatë periudhës të raportimit. Edhe shpenzimet operative për programet e tjera rezultojnë me një përqindje shumë të ulët të realizimit pasi këto shpenzime konsistojnë në realizimin e disa projekteve pjesë e buxhetit të vitit 2024 të cilat do të realizohen në periudhat në vazhdim.

Shpenzimet kapitale për periudhën 4 mujore janë me realizim 0, pasi periudha kur është parashikuar realizimi i tyre është në muajt e ardhshëm. Peshën më të madhe në fondin e investimeve e zënë investimet në sektorin e turizmit në bashkepunim me bashkitë si dhe projektet studimore që do të realizohen përsëri me bashkitë.

Ndërsa për sa i përket projekteve me financim të huaj, ato janë mbyllur brenda vitit 2023. Është parashikuar një fond që do të shërbejë si garanci për parafinancimet apo bashkëfinancimet për projektet e reja të huaja ku Qarku mund të bëhet pjesë.

Realizimi i shpenzimeve per 4/mujorin e parë të vitit 2024 paraqitet si më poshtë

Në 000/lekë

Nr.	Emertimi sipas Programeve	Plan 4mujor	Fakt 4 mujor	Diferenca	% realizim
<b>1</b>	<b>Administrata – Programi 01110</b>	<b>13278.5</b>	<b>6661.8</b>	<b>6616.7</b>	<b>50</b>
	Paga personeli	6000	5116.5	883.5	85
	Sigurime shogerore e shendetsore	1013	657.9	355.1	65
	Shpenzime operative, keshilltare	3644.7	866.6	2778.1	24
	Transferta korrente te brendshme	20.8	20.8	0	100
	Nga keto:				
	- Kontribut financiar per shkollën Tefta Tashko Koco per mbulimin e transportit per aktivitetin me nxenesit e shkollave te muzikes ne Maqedoni	20.8	20.8	0	100
	Investime kapitale	2600	0	2600	0
<b>2</b>	<b>Drejt.DAMT –Programi 01160</b>	<b>3530</b>	<b>2151.6</b>	<b>1378.4</b>	<b>61</b>
	Paga personeli	2800	1803.4	996.6	64.4
	Sigurime shogerore e shendetsore	600	279.4	320.6	46.7
	Shpenzime operative	130	68.8	61.2	53
	Transferta tek individet, familjaret				
<b>3</b>	<b>Bashkefinancim ne Projekte me fonde Bashkimit Europian-Programi 08220</b>	<b>4085</b>	<b>0</b>	<b>4085</b>	<b>0</b>
<b>4</b>	<b>Programi 08220</b>	<b>5190.4</b>	<b>0</b>	<b>5190.4</b>	<b>0</b>
	Shpenzime operative	3190.4	0	3190.4	0
	Shpenzime kapitale	2000	0	2000	0
<b>5</b>	<b>Programi 04130</b>	<b>24122.6</b>	<b>0</b>	<b>24122.6</b>	<b>0</b>
	Shpenzime operative	13800	0	13800	0
	Shpenzime kapitale	10322.6	0	10322.6	0
<b>6</b>	<b>Programi 06260</b>	<b>8748.7</b>	<b>0</b>	<b>8748.7</b>	<b>0</b>
<b>7</b>	<b>Fondi rezerve</b>	<b>2500</b>	<b>0</b>	<b>2500</b>	<b>0</b>
<b>8</b>	<b>Programi 10430</b>	<b>21935.9</b>	<b>1309.1</b>	<b>20626.8</b>	<b>6</b>
<b>9</b>	<b>Arsimi i mesem 09230</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
<b>10</b>	<b>Arsimi baze 09120</b>	<b>22</b>	<b>0</b>	<b>22</b>	<b>0</b>
<b>11</b>	<b>Projekt Rrjeti Rrugor rural-Programi 04520</b>	<b>21024.8</b>	<b>0</b>	<b>21024.8</b>	<b>0</b>
	<b>Total KESHILLI I QARKUT</b>	<b>104437.9</b>	<b>10122.5</b>	<b>94315.4</b>	<b>10</b>

Analiza analitike e shpenzimeve përperiudhen 4/mujore, (për Administratën)

Buxheti i periudhës 4 mujore të vitit 2024 për administratën e Këshillit të Qarkut (programi 01110) është realizuar në nivelin 50% dhe në vlerë absolute 6661.8 mije leke nga 13278.5 mije leke të programuara. Menaxhimi i buxhetit për këtë periudhë është bërë sipas programeve të miratuara në plan,

duke ruajtur një raport të drejtë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe duke patur një bilanc pozitiv të pagesave brenda limiteve të miratuara nga Këshilli i Qarkut.

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas strukturave përdorimi i fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion administrata e Këshillit të Qarkut për këtë periudhë rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **6661.8 mije leke ose 62.4%** ndaj planit prej **10678.5 mije leke** vetëm për programin 01110, të miratuar për administratën e Këshillit të Qarkut. Ecuria e shpenzimeve korrente për paga, sigurime shoqërore e shpenzime operative ka qënë në përpjestim të drejtë për çdo muaj duke përbushur të gjitha nevojat dhe detyrimet për funksionimin normal të Administratës. Mosrealizimi është kryesisht në shpenzimet operative. Ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit nuk janë parashikuar transferta korrente të brëndëshme në vlera të mëdha. Këshilli i Qarkut do të vazhdojë të mbështesë si më përpara të gjitha aktivitetet që ka mbështetur, por ndryshe nga më parë, duke i çfuar vetë shërbimet.

Mosrealizimi në zërin e pagave dhe sigurimeve lidhet me mospërdorimin e fondit të vecantë si dhe mospërdorimin e transfertë të pakushtëzuar sektoriale për ritjet e pagave.

#### ***a. Shpenzime për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)***

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për periudhën 4 mujore për personelin është kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Administrata perbehet nga 13 punonjës ( 10-3 ), të cilët paguhen me nivelin e pagave të miratuara në Këshillin e Qarkut. Fondet për financimin e këtyre shpenzimeve janë nga Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2024. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për këtë periudhë është në vlerën **5774.4 mije leke ose 82.3%** ndaj **7013 mije leke** të miratuara sipas programit. Kjo për shkak se Këshilli i Qarkut ka pasur një teprice kreditore në Drejtorinë e Tatimeve, të grumbulluara prej shumë vitesh më përpara, prej rreth 438 mijë lekësh. Që në momentin që kjo gjë ju bë me dije institucionit tonë nga ana e Drejtorisë së Tatimeve Korçë, këto teprica u përdorën për likuidimin e sigurimeve të muajit Mars, gjë që ka ndikuar në uljen e shpenzimeve për këtë zë. Gjithashtu edhe fondi i vecantë i parashikuar në zërin Paga, nuk është përdorur. Këshilli i Qarkut i ka përbushur të gjitha detyrimet ndaj punonjësve të tij për pagimin e pagave dhe sigurimeve dhe nuk ka paga apo sigurime të pa likuiduara.

#### ***b. Shpenzimet Operative, këshilltare (Artikulli 602)***

Realizimi i shpenzimeve operative, këshilltare për këtë periudhë është bërë në mbështetje të programeve dhe aktiviteteve të miratuara në Këshillin e Qarkut. Niveli i realizimit të këtyre shpenzimeve është **866.6 mijë lekë ose 24%** ndaj **3644.7 mijë lekë** të miratuara, vetëm për programin 01110. Për 4 mujorin e parë të vitit 2024 janë plotësuar të gjitha nevojat për aktivitetin e administratës dhe nuk kemi fatura të pa likuiduara. Disa nga aktivitetet dhe shpenzimet që ishin planifikuar për këtë periudhë, nuk u realizuan si psh, mirembajtje dhe riparim zyre, materiale elektrike apo hidraulike, shpenzime dekorimi, bileta transporti ndërkombëtar, kuota anetaresimi, materiale pastrimi, shërbim pastrimi etj.

Nga analiza niveli i shpenzimeve rezulton si më poshtë:

- Shpenzime për energji, uje telefona fix e celulare e shpenzime postare, shërbim pastrimi etj, Art. 602.2 janë realizuar në nivelin 270.6 mijë lekë.
- Shpenzime për riparim auto dhe transporti Art. 6023 janë realizuar në nivelin 0 lekë
- Shpenzimet për udhëtim e dieta Art. 6024 janë realizuar në nivelin 237.5 mijë lekë
- Shpenzime për pagesa të vendimeve gjyqësore Art. 6027 nuk ka. Këshilli i Qarkut nuk ka detyrime për shpenzime të tilla.
- Shpenzime për pagesën e shpërblimit për arëtarët e Kryesise të Këshillit të Qarkut si dhe shpenzimet për taksa dhe tarifa Art. 6029 janë realizuar në nivelin 358.5mije leke

Të gjitha shpenzimet janë bërë sipas programit buxhetor të miratuar në Këshillin e Qarkut për periudhën 4 mujore. Likuidimi i detyrimeve është bërë edhe kundrejt amortizimit të tyre të parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, si dhe në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 25 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024".

Shpenzimet për zërat e tjerë të parashikuar do të realizohen në muajt në vazhdim.

**c. Shpenzimet për Pagesat e Transfertave të Brendshme (Artikulli 604)**

Në këtë artikull janë përfshirë shpenzimet e planifikuara për transfertat e brendshme siç janë ato të Shoqatave të Verbërve të Qarkut Korçë, kontribut financiar për Qendrën e Shërbimit Paliativ Korçë, qendra rezidenciale e zhvillimit Korçë, pjesëmarrje në Projektin e përbashket me Bashkinë Korçë " Qendra ditore të moshës së tretë", projektin me shoqatën e bletërritësve, projekte me shkollat e mesme të rajonit, si dhe aktivitete të tjera që janë mbështetur nga Këshilli i Qarkut nëpërmjet Bashkive. Këshilli i Qarkut do të vazhdojë mbështetjen përsëri për të gjitha këto aktivitete, por ndryshe nga vitet e tjera, për një pjesë të tyre, Qarku do të financojë direkt aktivitetin sipas kërkesave që do të vijnë nga Bashkitë apo nga shoqatat me të cilat ai ka pasur marrëdhënie. Për këtë arsye këto shpenzime nuk janë parashikuar më në artikullin 604, por në atë 602, sipas programeve përkatëse. Konkretisht këtë 4/mujor Këshilli i Qarkut ka mbështetur me kontribut në formën e transfertës të brëndëshme shkollën Tefta Tashko Koco për mbulimin e kostove të transportit për një aktivitet të nxënësve të kësaj shkolle, në vlerën 20.8 mijë lekë, si dhe Bashkinë Maliq për mbulimin e kostove për pagën dhe sigurimet e një punonjësi shtesë në Qendrën e të moshuarve në këtë qytet, me vlerën 472.5 mijë lekë, duke qënë se Këshilli i Qarkut ka marrëveshje bashkëpunimi me bashkitë Korçë, Pogradec dhe Maliq për mbështetjen financiare të qendrave të të moshuarve që ndodhen në këto bashki.

**c. Shpenzimet Kapitale Investimet (Artikulli 230-231)**

Shpenzimet kapitale për periudhën 4 mujore kanë 0 realizim, nga plani prej 2600 mijë lekë. Këtu futen vetëm zërat e shpenzimeve kapitale që lidhen me programin 0110 si blerje pajisje për mbrojtjen nga zjarri, blerje pajisje ngrohjeje, pajisje për sigurinë e objektit, riparime në objekt etj. Realizimi i tyre do të bëhet në periudhën në vazhdim.

**Analiza analitike e shpenzimeve për funksionet e deleguara (DAMT në qark )**

Këshilli i qarkut në përmbushje të funksioneve të deleguara si funksioni i Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes të Tokës në qark, ka të programuar në Buxhetin e tij edhe fonde nga transfertat e kushtëzuar, të cilat delegohen nga Buxheti i Shtetit.

Gjatë kësaj periudhe shpenzimet e përgjithshme për funksionimin e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë realizuar në shumën 215.6 mije lekë nga 3530 mije lekë të



planifikuara. Shpenzimet e bëra për këtë funksion janë financuar 100 %. Në këtë mosrealizim ka ndikuar mungesa e 1 punonjësi për këtë periudhë.

#### ***Shpenzime për Paga dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)***

Shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për periudhën 4 mujori i parë i vitit 2024 për punonjësit e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Ministria e linjës si dhe nivelit të pagave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Për këtë periudhë, numri i punonjësve për këtë drejtori ka qënë 6 punonjës nga 7 të planifikuar. Aktualisht DAMT-ja ka vetëm 1 pozicion vakant. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore është vlerën **2082.8 mijë lekë**, kundrejt fondit të programuar në vlerë **3400 mijë lekë** ose e shprehur në përqindje në **61.3%**. Kjo lidhet me mungesën e 1 punonjësi për këtë periudhë dhe mos përdorimit të fondit të vecantë. Gjithashtu në këtë zë ka një planifikim me një rezervë të vogël.

#### ***Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (Artikulli 602)***

Për periudhën në fjalë, vlera e shpenzimeve operative është planifikuar 130 mijë lekë dhe realizimi i tyre është në nivelin 58.8 mijë lekë. Për këtë periudhë janë financuar vetëm shpenzime për energji elektrike dhe ujë në vlerë 30.5 mijë lekë, shpenzime postare në vlerë 31 mijë lekë, shpenzime telefonie 4.7 mijë lekë si dhe dieta me brenda në vlerën 2.5 mijë lekë.

#### **Realizimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut për pjesëmarrje në Programe ndërkombëtare**

Për vitin 2024 në Programin buxhetor të Këshillit të Qarkut është planifikuar vetëm 4085 mijë lekë buxhet, si garanci për parafinancimet apo bashkëfinancimet për projektet me fonde nga Bashkimi Europian, pjesë e të cilave do të jetë Këshilli i Qarkut. Këshilli i Qarkut në zbatim të funksioneve të përcaktuara me akte ligjore e nënligjore ka marrë pjesë gjerësisht në aplikimet për projekte sipas Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC si dhe në Programe të tjera ndërkufitare. Në fund të vitit 2023 u mbyllën edhe 3 projektet që kishin mbetur pa përfunduar, dhe janë në fazë kontrolli dhe certifikimi.

- Save –water me vlerë 802594.00 euro
- Waste React me vlerë 294000 euro
- CIID Cul Tour 164350.00 euro

Për këto projekte janë nënshkruar kontratat me partneret dhe ka filluar implementimi i tyre që në vitin 2018. Financimi i shpenzimeve për këto projekte ka filluar në vitin 2019 dhe ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023 sipas afateve të parashikuara në kontratat përkatëse. Të treja këto projekte kanë përfunduar si aktivitete, në fund të vitit 2023. Për këtë qëllim në Buxhetin e Këshillit të Qarkut për periudhën në fjalë nuk janë planifikuar fonde të tjera. Përkatësisht programet 06370, 05100 dhe 08220 janë programet që lidhen me projektet me financim të huaj. Konkretisht për këto projekte janë parashikuar limite me kapitull 2, për pjesën e rimbursimeve të shpenzimeve që Këshilli i Qarkut pret të marrë nga donatorët, për shpenzimet që faktikisht janë mbuluar me buxhetin e institucionit dhe që do të rimbursohen nga donatori pas certifikimit të shpenzimeve dhe aktiviteteve të kryera dhe që i takojnë pjesës prej 85% të financuar prej tyre. Gjithashtu Këshilli i Qarkut ka për të arkëtuar në llogaritë e veta në thesar edhe fondet që kanë ngelur si teprica në llogaritë e projekteve në Bankën e Nivelit të dytë, duke qënë se donatorët i celnin fondet pasi shpenzimet për to ishin kryer paraprakisht. Kapitulli 2 nuk është përfshirë në tabelat e monitorimit të buxhetit, të planit të buxhetit, pasi është thjesht 1 limit, dhe në

momentin që do të vijnë fondet e rimbursimit të shpenzimeve, ato celen nga thesari me kapitull 5, duke i shpërndarë me vendim këshilli sipas nevojave të institucionit. Rimbursimi i shpenzimeve është përfshirë në buxhet vetëm në momentin që celet si e ardhur Konkretisht, për periudhën në fjalë janë celur si rimbursim shpenzimesh vetëm 9044 mijë lekë të cilat janë pasqyruar te buxheti i rishikuar 2024.

Për sa i përket programeve të tjera si programi 04130, 06260, 08220, 04520, realizimet për këtë periudhe janë 0. Këto programe konsistojnë në projekte të ndryshme të miratuara me Buxhetin e vitit 2024, që Këshilli i Qarku ka marrë nismën të financojë dhe që do të realizohen në periudhën në vazhdim.

Programi 10430 që konsiston në projektet sociale, përveç fondit të planifikuar të Këshillit të Qarkut, përfshin edhe transfertën e kushtëzuar të Ministrisë të Shëndetësisë, për mbështetjen e pagave dhe sigurimeve për 11 punonjës të Qëndrave ditore të moshës të tretë në 3 bashki të Qarkut.

Aktualisht % e realizimit të shpenzimeve operative, artikulli 602 dhe 604 në total buxheti është shumë e ulët, rreth 5%, kjo për faktin se realizimi i aktiviteteve dhe projekteve ku konsiston buxheti i Këshillit të Qarkut për këtë vit, do të bëhet në periudhat në vazhdim.

I njëjti arsyezim vlen edhe për investimet kapitale të parshkujara në programet 01110, 04130, 08220 dhe 04520. Realizimi i tyre do të varet edhe nga gadishmëria e bashkive për të bashkëpunuar.

Në lidhje me aneksin 3 dhe 4, treguesit e performancës në aneksin 3 i përfshijnë të gjitha programet funksionale, pra ata janë të ndara sipas programeve. E njëjta gjë vlen edhe për aneksin 4, të gjitha programet funksionale janë përfshirë në këtë aneks.

Financier

Oljona Beqiraj



**KRYETAR I KËSHILLIT TË QARKUT**

**Erjon Nexhipi**

